

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË  
“FLY TRAVEL 2010” SH.P.K.**

**KREU I  
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA DHE ADRESA E FAQES SË  
INTERNETIT**

Në Tiranë, sot më datë 25.09.2017, ne, të poshtëshënuarit:

- Jonid ZAHAJ, i biri i Bashkimit dhe i Elianes, me datëlindje 30.03.1990, lindur dhe banues në Tiranë, adresa Rr. Islam Alla , Nr.24, posedues i letërnjoftimit shqiptar me Nr. BJ0276775, Nr. Cel: +355696561019, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- Alisa BEGA, e bija e Enverit dhe e Firmires, me datëlindje 11.11.1990, lindur dhe banuese në Tiranë, adresa Rr. Ibrahim Hasmema, Nr. 15, posedues e letërnjoftimit shqiptar me Nr. BC7932059, Nr. Cel: +355696134737, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për te vepruar.

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, themelojmë shoqërinë tregtare “FLY TRAVEL 2010” SH.P.K.

**Neni 1  
Objekti**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Agjenci udhëtimi
- Dhenie makinash me qera

**Neni 2  
Kohëzgjatja**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të kryejë aktivitet tregtar për një afat të pacaktuar.

**Neni 3  
Selia, Adresa e faqes së internetit dhe Adresa Elektronike**

1. Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: “Pallatet Agimi”, Shkalla nr.1, Kati i dytë.
2. Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është: [www.fly-travel.al](http://www.fly-travel.al)
3. Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [fly\\_travel\\_1@hotmail.com](mailto:fly_travel_1@hotmail.com)

**KREU II  
KAPITALI**

**Neni 4  
Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në vlerën 100,000.00 (njëqind mijë) Lekë, i ndarë në dy pjesë të barabarta, dy kuota, midis ortakëve të shoqërisë.  
Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë janë në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:
  - Ortaku, Z. Jonid ZAHAJ, lloji i kontributit: PARA, në vlerën: 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) Lekë, kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë 50%.
  - Ortaku, Znj. Alisa BEGA, lloji i kontributit: PARA, në vlerën: 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) Lekë, kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë 50%.

2. Kapitali i rregjistruar, në vlerë totale: 100,000. 00 (njëqind mijë) Leke, vlera e paguar: 100,000.00 (njëqind mijë) Lekë.

#### Neni 5

### Mënyrat e fitimit dhe kalimit të Kuotave

1. Kuotat e kapitali të shoqërisë dhe të drejtr, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
  - b) shutblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

#### Neni 6

### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Kapitali i rregjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës.
2. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, me shumicë të kualifikuar të votave të ortakëve.
3. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë, krahas parashikimeve të këtij neni, mund të kryhet edhe përmes të gjitha formave të tjera të njohura apo të ardhshme ligjore.
4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të asamblesë së përgjithshme, me shumicë të kualifikuar të votave të ortakëve.

## KREU III

### Neni 7

### Organet Vendimmarrëse dhe Drejtuese

Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori/ët

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

1) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.  
Ortaku mund të përfaqësohet në asambleshë e përgjithshme, në baze të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.  
Administratori i shoqërisë, kur është i ndryshëm nga ortaku, nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asambleshë e përgjithshme.  
Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 8

### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori/ët, me kërkesën e ortakëve, e përcaktuar sipas nenit 84 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 9

### Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme marrë vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
2. Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.
3. Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
4. Administratori, pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Asambleja vendos me votim të hapur, me përjashtim të rastit kur, përpara apo gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet, në mënyrën e duhur, një votim i fshehtë.

#### Neni 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 11

### Marrja e vendimeve Votat e Ortakëve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katertat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, apo edhe për çeshtje të tjera të përcaktuara në nenin 8, më lart.

2. Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut –individ të pranishëm, apo përfaqësuesit të tij të autorizuar, ose ortakut -person juridik, që është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
3. Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi, do të komunikohet kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar.

#### Neni 12

#### Përfashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në rast se Asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) Ngritjen e një padië ndaj tij nga shoqëria;
- d) Dhënicen ose jo të përfundimeve të teja.

#### Neni 13

#### Administratorët

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë dhe përfaqësues të Shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë rripërtëriuje. Emërimi prodhon efekte pas regjistrimit në QKR.
2. Personat e mëposhtem caktohen si Administratorët e parë të Shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:

Zahaj, Jonid, Rr. Islam Alla, Nr. 24

Bega, Alisa, Rr. Ibrahim Hasmema, Nr. 15

Administratori do të caktohet si kryetar i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në mbledhjen e saj të parë.

#### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorit

Detyrat e Administratorit janë si më poshtë:

- a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
  - i. ka të drejtën e krijes së veprimeve me bankë deri në vlerën 30.000 euro
  - ii. ka të drejta të pakufizuara në veprimet me klientët
  - iii. ka të drejta të pakufizuara në veprimet me furnitorët
  - iv. ka të drejta të pakufizuara në lidhje me punësimin/largimin e punonjësve
- b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- d) Të përgansë dhe nënshkruajë bilanci vjetorë dhe të konsoliduara dhe raportin e curisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për QKR;
- g) Raporton para asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

#### Neni 15

#### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht, sipas rastit, pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;  
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të heqimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga kero veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpëmdan aktivitet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjëndjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Neni 16

### Shpërblimi, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorëve

1. Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e përgjithshme në përputhje me parashikimin e nenit 97 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
2. Asambleja e përgjithshme mund të parashikojë përfitime nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person që ka qenë po nuk është më në detyrë, apo i punësuar në shoqëri;
3. Administratorëve mund t'ju paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera të lidhura me plotësimin e detyrave të tyre.

#### Neni 17

### Shkarkimi i Administratorëve

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- i) personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme në pajtim me pikën 6 të nenit 95 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- ii) personi ndodhet në gjendje pa aftësi paguese;
- k) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;

- l) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose  
m) ka munguar për më shumë se gjashtë muaj rradhazi pa lejen e Asamblesë së Përgjithshme, e cila vendos ta shkarkojë nga detyra.

#### **Kreu IV**

##### **Neni 18**

#### **Viti Financiar dhe Bilanci**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor. Kjo është periudha për të cilën përgatiten pasqyrat financiare dhe raportimi financiar nga administratori/ët.

##### **Neni 19**

#### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **KREU V**

#### **DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR**

##### **Neni 20**

#### **Dividendët**

1. Në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 77, shoqëria me shumicë të kualifikuar të vorave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të përnudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfundimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
3. Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e kotës.

##### **Neni 21**

#### **Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 14 i Ligjit 9901, i ndryshuar, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervë ligjore ose kapitali.

#### **KREU VI**

#### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

##### **Neni 22**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar prishet:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me pikën 3, neni 43, të Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit"
- e) Me vendim të Gjykatës

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë nenet 191 deri në 203 të ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedure të thjeshtëzuar në përputhje me neni 204 dhe 205 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.


Neni 23  
Baza Ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**ORTAKËT THEMELUES:**

Z. Jonid ZAHAJ

Znj. Alisa BEGA



Tiranë më 25. 09. 2017